

LIGJ
Nr. 51/2015

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRIA E FINANCIVE, DHE BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM, SI ADMINISTRATOR I FONDEVE GRANT, TË SIGURUARA NGA
QEVERI TË VENDEVE TË NDRYSHME NËN FONDIN E VEÇANTË TË
AKSIONARËVE TË BERZH-IT, PËR BY-PASS-ET RRUGORE TË FIERIT DHE
VLORËS, ASISTENCË TEKNIKE PËR MBËSHTETJEN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT
NË SHQIPËRI**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si administrator i fondeve grant, të siguruar nga qeveri të vendeve të ndryshme nën fondin e veçantë të aksionarëve të BERZH-it, për by-pass-et rrugore të Fierit dhe Vlorës, asistencë teknike për mbështetjen e zbatimit të projektit në Shqipëri, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.5.2015

**Shpallur me dekretin nr. 9119, datë 27.5.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

C28150/EBSF-2013-12-226/Rev01

Marrëveshje Granti nr. C28150/EBSF-2013-12-226/Rev01

MARRËVESHJE GRANTI

**PËR RRUGËT E BYPASS-it TË FIERIT DHE VLORËS: ASISTENCË TEKNIKE PËR
MBËSHTETJEN E ZBATIMIT TË PROJEKTIT NË SHQIPËRI NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
FINANCIVE DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, SI
ADMINISTRATORE E FONDEVE TË GRANTIT, TË SIGURUARA NGA QEVERITË E VENDEVE TË
NDRYSHME NËN FONDIN E POSAÇËM TË AKSIONARËVE TË BERZH-it**

xxxx/2014

Marrëveshje Granti nr. C28150/EBSF-2013-12-226/Rev 01, datë xxxx/2014, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (Marrësi) dhe Bankës

Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka ose BERZH), me seli në One Exchange Square, London EC2A 2JN, Mbretëria e Bashkuar, një institucion financiar ndërkombëtar i krijuar sipas Marrëveshjes për Krijimin e Bankës, të nënshkruar në Paris, më 29 maj 1990, e cila vepron në cilësinë e administratorit të Fondeve të Grantit që mbahen në Fondin e Posaçëm të Aksionarëve të BERZH-it, të siguruar nga qeveritë e vendeve të ndryshme (Donatori).

PREAMBULË

Duke marrë parasysh se Bankës i është kërkuar të marrë në konsideratë që t'i ofrojë Marrësit bashkëpunim teknik, në formën e financimit të shërbimeve të konsulencës për rrugët e Bypass-it të Fierit dhe të Vlorës (Projekti), duke përfshirë Asistencën Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Projektit (Shërbimet),

duke marrë parasysh se Autoriteti Rugor Shqiptar (Përfituesi i Grantit ose ARRSH) duhet të pajtojë një konsulent (Konsulentin) në përputhje me Politikën dhe Rregullat e Prokurimit dhe procedura të tjera të BERZH-it,

duke marrë parasysh se “ARRSH” do të lidhë një Kontratë Konsulencë për sigurimin e Shërbimeve të Konsulentit (Kontrata e Konsulencës) për një vlerë tavan deri në 249,996.00 euro,

duke marrë parasysh se në përputhje me Marrëveshjen e Grantit për Bashkëpunimin Teknik, ndërmjet Donorit dhe Bankës, Donatori ka miratuar dhe ka rënë dakord të vërë në dispozicion fonde deri në vlerën 249,996.00 euro mbi bazë granti (Granti) për financimin e Shërbimeve të Konsulentit sipas termave dhe kushteve të përcaktuar,

duke marrë parasysh se Marrësi duhet të marrë çdo masë dhe të gjitha masat e kërkuara në përputhje me legjislacionin shqiptar për të mundësuar Grantin tek ARRSH-ja. ARRSH-ja, nëpërmjet një marrëveshjeje transferimi, për qëllimet e specifikuar në termat dhe kushtet e përcaktuar në këtë Marrëveshje,

duke marrë parasysh se Marrësi do të sigurojë si një kusht për marrjen e Grantit që, në mënyrë që të sigurojë përfitimin e duhur nga Shërbimet, Përfituesi duhet të përmbushë të gjitha detyrimet kontraktuale të shprehura në këtë Marrëveshje Granti, të cilat do të bien mbi ARRSH-në,

duke marrë parasysh se Banka ka pranuar të administrojë Grantin sipas termave dhe kushteve të përcaktuar,

për këto arsye, palët bien dakord me kushtet e shprehura më poshtë:

Neni 1

Përkufizime

1.01 Përkufizime dhe interpretime

Kurdo që përdoren në këtë Marrëveshje, përveç nëse nuk shprehen ndryshe nga konteksti, termat e mëposhtëm me germa kapitale do të kenë kuptimet e dhëna më poshtë:

- a) “Kostot e Faktimit” nënkupton kostot e shërbimeve;
- b) “Banka ose BERZH” nënkupton Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
- c) “Përfituesi i Grantit” nënkupton ARRSH-në, palën së cilës do t'i ofrohen shërbimet sipas Kontratës së Konsulencës;
- d) “Angazhimi i ARRSH-së” nënkupton kontributin financiar të ARRSH-së për të mbuluar koston e sigurimit të Shërbimeve;
- e) “Konsulentin” nënkupton palën që do të kryejë Shërbimet;
- f) “Kontrata e Konsulencës” nënkupton marrëveshjen e lidhur ndërmjet ARRSH-së dhe Konsulentit për kryerjen e Shërbimeve;
- g) “Vendi i Faktimit” nënkupton Shqipërinë;
- h) “Donator” nënkupton siguresin e Grantit, siç specifikohet në preambulën e kësaj Marrëveshjeje;
- i) “Grant” nënkupton shumën e fondeve që vihen në dispozicion nga Donatori te Banka, si administrator, për qëllimet e financimit të Kontratës së Konsulencës;
- j) “Marrëveshje Granti” nënkupton këtë Marrëveshje dhe të gjitha shtojcat që i bashkëlidhen, përfshirë edhe ndryshimet që mund të bëhen herë pas here;

k) “Vlera maksimale e Kontratës” nënkupton vlerën maksimale deri në 249,996.00 euro, e cila i paguhet Konsulentit sipas një Kontrate Konsulence, duke përfshirë të gjitha tarifat, fondet rezervë dhe shpenzime të tjera;

l) “Drejtuksi i Operacioneve” nënkupton anëtarin e stafit të Bankës që është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kontratës së Konsulencës në emër të Bankës;

m) “Marrësi” nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave;

n) “Shërbimet” nënkupton Shërbimet që do të kryhen nga Konsulenti për ARRSH-në, të përcaktuara në Kontratën e Konsulencës.

1.02 Interpretimi

a) Titujt në këtë Marrëveshje janë përdorur për lehtësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj;

b) Në këtë Marrëveshje, referencat të një akti janë të tilla siç gjenden tek akti dhe rregulloret e përgatitura në përputhje me këtë akt dhe me ndryshimet e herëpashershme që mund të bëhen në to dhe që hyjnë në fuqi, si dhe të çdo akti dhe rregullore që mund të miratohen e që mund të kenë efekt në plotësimin e mëtejshëm apo në zëvendësimin e këtij akti apo rregulloreve;

c) Në këtë Marrëveshje, referencat të një gjini përfshijnë një referencë të të gjitha gjinitë e tjera, numri njëjës do të përfshijë edhe numrin shumës dhe anasjellas, si dhe referencat të personat do të përfshijnë edhe shoqëritë, të krijuara ose jo, si dhe partneritetet. Referencat të personat do të përfshijnë edhe pasardhësit dhe drejtëmarrësit e autorizuar.

Neni 2

Granti

2.01 Granti

a) Banka bie dakord që t’i vërë në dispozicion Marrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuar në këtë Marrëveshje, Grantin në masën që nuk duhet të kalojë 249,996.00 euro ose ekuivalenten e kësaj shume;

b) Granti do të zbatohet vetëm për të financuar Shërbimet gjatë kohës së angazhimit të Konsulentit.

2.02 Disbursimi

a) Marrësi dhe Banka bien dakord që Banka do të jetë e autorizuar të kryejë disbursimet drejtpërsëdrejti të Konsulentit në emër të ARRSH-së.

b) Shuma e Grantit do të disbursohet drejtpërsëdrejti nga Banka te Konsulenti, në emër dhe sipas udhëzimeve të ARRSH-së dhe në përputhje me dispozitat e Kontratës së Konsulencës.

c) Pas paraqitjes së një fature dhe dokumenteve mbështetëse nga Konsulenti, të paraqitura në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate Konsulence, ARRSH-ja do të kontrollojë sa më shpejt që ta çmojë të arsyeshme, si dhe të verifikojë faturën dhe përmbushjen e kënaqshme të këtyre Shërbimeve nga Konsulenti për të cilat është lëshuar kjo faturë.

d) Nëse këto shërbime konstatohen të kënaqshme dhe ARRSH-ja është e bindur se shumatat e caktuara në faturë korrespondojnë me shifrat e caktuara në Kontratën e Konsulencës, fatura, dokumentet mbështetëse dhe një deklaratë (ashtu siç përcaktohen në shtojcën A të Marrëveshjes së Grantit), që vërtetojnë miratimin e Shërbimeve, duhet t’i përcillen më pas Bankës për pagesë në selinë e saj të godinës “Torre Drin”, kati i katërt, rruga “Abdi Toptani”, Tiranë, Shqipëri.

2.03 Taksat dhe tatimet

a) ARRSH-ja bie dakord që fondet e Grantit nuk do të përdoren për të financuar asnjë taksë të tërthortë (përfshirë TVSH-në) që ka lidhje me Shërbimet ose me këtë Marrëveshje Granti, taksë, e cila mund të përbëjë detyrim sipas ligjeve dhe rregullave të cilat janë në fuqi në vendin ku kryhen shërbimet.

b) ARRSH-ja duhet ta informojë Bankën nëse ndonjë taksë e tërthortë (përfshirë TVSH-në) përbën detyrim që ka lidhje me këtë Kontratë Konsulence.

c) ARRSH-ja pranon që çdo lloj takse e tërthortë (përfshirë TVSH-në) duhet të paguhet nga ARRSH-ja për Konsulentin.

d) Nëse ndonjë lloj takse e tërthortë (përfshirë TVSH-në) është e faturueshme, në paraqitjen e një vërtetimi

për Bankën sipas pikës 2.02 (d), ARRSH-ja duhet të vërtetojë, gjithashtu, pagesën që ka bërë për këto taksa të tërthorta (përfshirë TVSH-në), të pagueshme për çdo faturë të mëparshme të Konsulentit dhe të marrë përsipër të paguajë taksat e tërthorta (përfshirë TVSH-në) mbi faturën aktuale.

e) Nëse ARRSH-ja nuk është në gjendje të paguajë të gjitha taksat e tërthorta (përfshirë TVSH-në), kjo mund të çojë në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje në përputhje me pikën 5.03.

Neni 3

Ekzekutimi i Projektit

3.01 Bashkëpunimi dhe informacioni

a) Banka dhe ARRSH-ja do të bashkëpunojnë plotësisht në lidhje me administrimin e Kontratës së Konsulencës.

Banka, përfituesi dhe ARRSH-ja duhet që herë pas here, sipas kërkesës së tyre, të shkëmbejnë mendime në lidhje me progresin e Projektit, Shërbimet, qëllimet për të cilat është dhënë Granti, përmbushjen dhe detyrimet e ARRSH-së sipas kësaj Kontrate dhe të paraqesin te pala tjetër të gjithë informacionin që mund ose duhet të jetë kërkuar nga pala tjetër.

b) ARRSH-ja duhet të informojë menjëherë Bankën për çdo lloj ndryshimi që mund të propozohet në lidhje me natyrën dhe qëllimin e Projektit, ose për Shërbimet apo biznesin dhe operacionet e ARRSH-së në çdo rast ose rrethanë që mund të ndikojë materialisht në kryerjen e projektit, ose Shërbimet apo operacionet dhe biznesin që kryhet nga ARRSH-ja.

c) Pa cenuar nga sa është përcaktuar përgjithësisht më sipër, ARRSH-ja nuk duhet të bëjë asnjë ndryshim material, përfshirë ndonjë vendim në lidhje me caktimin dhe nënkontraktimin, në këtë Kontratë Konsulence, pa marrë paraprakisht pëlqimin me shkrim nga Banka, pëlqim, i cili nuk duhet të tërhiqet për shkaqe të paarsyeshme. Në çdo rast, të gjitha ndryshimet e kësaj Kontrate Konsulence duhet t'i njoftohen Bankës nga ARRSH-ja.

3.02 Mbajtja e të dhënave dhe raportimi

a) ARRSH-ja duhet që:

i) të sigurojë procedura dhe të dhëna të përshtatshme për të siguruar monitorimin e progresit të Shërbimeve (përfshirë kostot e tyre dhe përfitimet që rrjedhin prej tyre), si dhe të identifikojë Shërbimet e financuara nëpërmjet Grantit, duke i vënë këto të dhëna në dispozicion të përfaqësuesve të Bankës me kërkesë të Bankës;

ii) të mbajë llogaritë dhe pasqyrat financiare (bilancet, pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve), të nevojshme për monitorimin dhe raportimin e progresit të Shërbimeve (përfshirë kostot e tyre dhe përfitimet që rrjedhin prej tyre), si dhe me kërkesë të Bankës, t'i japë asaj kopje të këtij informacioni në masën e duhur dhe të arsyeshme;

iii) t'i lejojë përfaqësuesit e Bankës, sipas kërkesës së kësaj të fundit, të vizitojnë ambientet që përshkruhen apo të përmendura në Projekt ose në Kontratën e Konsulencës, që të kontrollojnë Shërbimet e financuara nga të ardhurat e Grantit dhe të gjitha impiantet, repartet, kantieret, godinat, pronat, pajisjet, të dhënat dhe dokumentet që kanë lidhje me përmbushjen ose detyrimet e ARRSH-së ose të Konsulentit sipas kësaj Marrëveshjeje ose Kontrate Konsulence;

iv) t'u japë përfaqësuesve të Bankës të gjithë informacionin e kërkuar në mënyrë të arsyeshme nga Banka, në lidhje me Projektin dhe shërbimet, kostot e tyre dhe, në rastet kur çmohet e arsyeshme, përfitimet e rrjedhura prej tyre, si dhe shpenzimet e kryera nëpërmjet Grantit;

v) t'u japë përfaqësuesve të Bankës ose të bëjë të mundur dhënien, menjëherë pas përgatitjes, të planimetrive, specifikimeve, raporteve, kontratave, dokumenteve (përfshirë produktet e dorëzueshme sipas kësaj Kontrate Konsulence), si dhe çdo material tjetër që rrjedh prej tyre, në një shkallë të caktuar hollësisht sipas kërkesës së arsyeshme nga Banka.

b) Menjëherë pas përfundimit të Shërbimeve, ARRSH-ja duhet të përgatisë dhe t'i sigurojë Bankës një raport në gjuhën e caktuar për këtë qëllim, sipas objektit dhe hollësive të caktuara të kërkuara në mënyrë të arsyeshme nga Banka, në lidhje me kryerjen dhe funksionimin e Shërbimeve, përfshirë kostot dhe përfitimet që rrjedhin apo do të sigurohen prej tyre, si dhe përmbushjen nga ana e ARRSH-së, performancën e Konsulentit dhe të Bankës në lidhje me detyrimet e tyre përkatëse sipas kësaj Marrëveshjeje Granti dhe

Kontrate Konsulence, sipas rastit;

c) Të gjitha raportet dhe të dhënat e mbajtura nga ARRSH-ja duhet të krijohen në programin Microsoft Word dhe/ose në Excel, të jenë në përputhje me programin Acrobat, si dhe të dorëzohen në formë dokumenti dhe formë elektronike.

3.03 Konfidencialiteti

Përveç kur sigurohet pëlqimi me shkrim nga ana e Bankës, ARRSH-ja dhe Marrësi nuk duhet të nxjerrin dhe as të bëjnë të mundur që nëpërmjet agjentëve të tyre apo nënkontraktorëve të zbulojnë informacion te palët e treta, dhe as të përdorin për qëllimet e veta asnjë informacion që ka lidhje me Shërbimet, Projektin ose Bankën, përfshirë informacionin që i përket Kontratës së Konsulencës. ARRSH-ja dhe Marrësi mund të japin ndonjë informacion të kësaj natyre që mund të kërkohej nga ligji apo kuadri rregullator, por vetëm atë pjesë të informacionit, e cila, në masën e lejuar nga ligjet apo rregullat, kërkohej të jepet ligjërisht. Nëse bëhet një kërkesë e tillë, ARRSH-ja dhe Marrësi duhet të informojnë menjëherë Bankën.

3.04 Kryerja e operacioneve

Nëse Banka nuk bie dakord ndryshe, ARRSH-ja duhet të kryejë biznesin dhe operacionet e veta (përfshirë operacionet nga degët e veta), në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtarisht të njohura, standardet dhe praktikat administrative, teknike, financiare dhe mjedisore nën mbikëqyrjen e menaxherëve të kualifikuar dhe me përvojë, të ndihmuar nga personel kompetent në një numër të pranueshëm.

3.05 Mbështetja nga ana e Marrësit

Marrësi duhet që:

- i) të kryejë sipas rregullave detyrimet e veta sipas kësaj Marrëveshjeje;
- ii) të mbështesë ARRSH-në në përmbushjen e të gjitha detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, përfshirë marrjen përsipër të të gjitha veprimeve ligjore, rregullatore ose veprimeve të tjera të nevojshme apo që kërkohej, si dhe të vërë në dispozicion apo të sigurojë që janë mundësuar fonde dhe mbështetje për ARRSH-në dhe kur i nevojiten ARRSH-së për përfundimin e projektit; si dhe
- iii) të ndërmarrë çdo lloj veprimi që është i nevojshëm sipas legjislacionit shqiptar për t'i dhënë fuqi kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Përfaqësimi

4.01 Përfaqësuesi i Autorizuar

Çdo veprim i kërkuar apo i lejuar për t'u marrë, si dhe çdo dokument i kërkuar ose që lejohet të ekzekutohet sipas kësaj Marrëveshjeje, do të merret apo ekzekutohet:

- a) në emër të Marrësit nga Ministria e Financave apo nga ndonjë përfaqësues i caktuar prej saj;
- b) në emër të ARRSH-së nga drejtori i përgjithshëm apo nga ndonjë përfaqësues i caktuar prej tij; si dhe
- c) në emër të Bankës nga drejtori i Bashkëpunimit Teknik ose nga ndonjë përfaqësues tjetër i autorizuar i Bankës.

4.02 Njoftimet ose kërkesat

Çdo njoftim, kërkesë ose pëlqim i kërkuar ose që lejohet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, duhet të jetë me shkrim në gjuhën angleze. Njoftime të tilla, kërkesa ose pëlqime të pranura ose të kërkuara konsiderohen që janë dhënë nëse janë dorëzuar personalisht te një përfaqësues i autorizuar ose te pala së cilës i drejtohet komunikimi, ose kur janë dërguar me postë të regjistruar ose faks te kjo palë në adresat e mëposhtme.

Për Marrësin

Në vëmendje të:

Shkëlqim Cani

Ministër i Financave

Ministria e Financave

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 4 222 8405

Për ARRSH-në

Në vëmendje të: Dashamir Xhika

Adresa: Rruga "Sami Frashëri", nr. 33, Tiranë, Shqipëri

Telefon: +355 4 2226 373

E mail: dashamir.xhika@arrsh.gov.al

Për Bankën

Adresa: Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

One Exchange Square,

London EC2A 2JN, United Kingdom

Në vëmendje të: Donald Mishaxhiu, Drejtuesi i Operacioneve

Telefon: +44 20 7338 7109

E mail: mishaxhd@ebrd.com

a) Njoftimi do të konsiderohet i kryer si më poshtë:

i) në rast se dorëzohet personalisht ose me postë rekomande pas dorëzimit; si dhe

ii) në rast të dërgimit me faks me marrjen e konfirmimit të transmetimit.

b) Ndonjë nga palët mund ta ndryshojë adresën e saj për qëllimin e marrjes së njoftimeve ose kërkesave, duke i dhënë palës tjetër njoftim në kohë të arsyeshme në përputhje me këtë klauzolë.

Neni 5

Pezullimi dhe përfundimi

5.01 Njoftimi i ARRSH-së

ARRSH-ja do të njoftojë menjëherë Bankën mbi pezullimin ose përfundimin e Kontratës së Konsulencës, ose për ndonjë rast që mund të çojë në pezullimin ose përfundimin e Kontratës së Konsulencës.

5.02 Pezullimi i disbursimeve

Nëse mund të ndodhë ndonjë nga ngjarjet dhe këto raste vijnë, Banka mundet, me njoftim me shkrim, të njoftojë menjëherë Marrësin mbi pezullimin e pjesshëm apo të plotë të disbursimeve që i detyrohet Konsulentit në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje:

a) kur Banka ka pezulluar disbursimet nga huaja për Marrësin për këtë Projekt, nëse ka;

b) Kontrata e Konsulencës është pezulluar ose përfunduar në përputhje me kushtet e Kontratës së Konsulencës;

c) ARRSH-ja nuk ka kryer pagesën e ndonjë elementi nga taksat e tërthorta (përfshirë TVSH-në) në lidhje me faturat e Konsulentëve për Konsulentin në kohën e duhur në përputhje me kushtet e Kontratës së Konsulencës;

d) ndonjë kusht tjetër është krijuar, sipas të cilit, në gjykimin e arsyeshëm të Bankës, ndërhyrje ose rrezikon të ndërhyrje në kryerjen e suksesshme të Shërbimeve të Projektit ose arritjes së qëllimeve të kësaj Marrëveshjeje.

5.03 Përfundimi i kësaj Marrëveshjeje nga Banka

a) Banka mundet që me njoftim me shkrim, të njoftojë menjëherë Marrësin në lidhje me përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, nëse:

i) ndonjë nga kushtet e përmendura në klauzolën 5.02 vazhdon për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh pasi Banka të ketë pezulluar në mënyrë të pjesshme apo të plotë disbursimet që i detyrohet Konsulentit dhe t'i ketë dhënë për këtë arsye njoftim Marrësit; ose

ii) Marrëveshja e Huas për Projektin, nëse ka, ose Kontrata e Konsulencës të ketë skaduar ose të jetë përfunduar në përputhje me kushtet e saj; ose

iii) Marrësi dhe Banka bien dakord t'i japin fund në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje; ose

iv) Donatori anulon fondet e Grantit; ose

v) Prokurimi i ndonjë prej Shërbimeve nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje; ose

vi) Fondet e disbursuara sipas kësaj Marrëveshjeje janë përdorur për qëllime të ndryshme nga ato të përcaktuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Në çdo rast, Banka mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në çdo kohë duke i dhënë njoftim Marrësit jo më pak se dyzet ditë nga data e përfundimit.

5.04 Procedurat e përfundimit

Pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me klauzolën 5.03, ARRSH-ja duhet të ndërmarrë menjëherë hapat për zvogëlimin e humbjeve dhe të minimizojë shpenzimet e mëtejshme të Kontratës së Konsulencës.

Neni 6 Të përgjithshme

6.01 Shmangia e përgjegjësisë

Pavarësisht nga ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje, Banka nuk do të jetë përgjegjëse ndaj Marrësit, ARRSH-së apo Konsulentit sipas ose në lidhje me këtë Marrëveshje ose Kontratës së Konsulencës për çfarëdolloj humbjeje apo dëmtimi, të shkaktuar apo jo nga neglizhencat apo mosveprimi nga ana e Bankës. Kjo dispozitë nuk zbatohet në lidhje me ndonjë akt neglizhent apo mosveprim të Bankës që bëhen shkak për vdekje ose dëmtime personi qoftë nga ARRSH-ja apo të Konsulentëve ose ekspertëve të Konsulentit.

6.02 Dëmshpërblimi

ARRSH-ja duhet të dëmshpërblejë dhe në bazë të privilegjeve dhe imuniteteve të Bankës, të mbrojë Bankën, drejtorët e saj, punonjësit, agjentët dhe kontraktorët ndaj çdo lloj ankese, dëmtimi, kostosh, shpenzimesh, përgjegjësish, procedimeve, humbjeve që lindin ose kanë lidhje me çdo lloj veprimi ose mosveprimi, qoftë i gabuar, nga neglizhenca apo për shkaqe të ndryshme, ndaj ARRSH-së ose Konsulentit, punonjësve të vet, nënkontraktorëve dhe agjentëve, për ndonjë shkelje nga ana e tyre të detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, Kontratës së Konsulencës ose ndonjë mospërmbushje nga ana e tyre për të zbatuar siç duhet aktet, rregullat dhe rregulloret.

6.03 Praktika e ndaluar

Banka, pa cenuar ndonjë mjet tjetër ligjor për shkelje të Marrëveshjes, mund ta përfundojë këtë Marrëveshje menjëherë nëse Marrësi dhe/ose ARRSH-ja, sipas gjykimit të Bankës, janë përfshirë në praktika të ndaluara konkurruese për ose zbatimin e Kontratës së Konsulencës.

“Praktikë korruptive” nënkupton ofrimin, dhënien, marrjen ose nxitjen, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të gjithçkaje me vlerë për të ndikuar në mënyrë të padrejtë te veprimet e palës tjetër, në lidhje me procesin e përzgjedhjes ose të zbatimit të Kontratës, me qëllim që të sigurohen ose ruhen avantazhe biznesi ose avantazhe të tjera të papërshtatshme në kryerjen e biznesit.

“Praktikë mashtrimi” do të thotë çdo lloj veprimi apo mosveprimi, duke përfshirë një keqpërfaqësim, nëpërmjet të cilit, me dijeni ose jo, çon apo synon të çojë në drejtim të gabuar njëren nga palët, me qëllim që të sigurohet përfitim financiar ose përfitim tjetër ose për të shmangur një detyrim.

“Praktikë shtrënguese” nënkupton dëmtimin ose cenimin, ose rrezikun për dëmtim ose cenim, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, të ndonjërës prej palëve ose të pronës së kësaj pale, për të ndikuar në mënyrë të padrejtë te veprimet e palës tjetër në lidhje me procesin e përzgjedhjes ose të zbatimit të Kontratës, me qëllim që të sigurohen ose ruhen avantazhe biznesi ose avantazhe të tjera të papërshtatshme në kryerjen e biznesit.

“Praktikë bashkëpunuese” do të thotë një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve që synon të arrijë një qëllim të padrejtë që përfshin ndikimin te veprimet e ndonjë pale tjetër dhe përfshin edhe marrëveshjet midis konsulentëve (para ose pas paraqitjes së propozimeve), të krijuar posaçërisht për të mbajtur çmimet në nivele artificiale jokonkurruese dhe që t’i heqë ARRSH-së përfitimet e një konkurrence të lirë dhe të hapur.

6.04 Inspektimi dhe Auditimi nga Banka

ARRSH-ja do ta lejojë Bankën ose përfaqësuesit e saj të autorizuar, të inspektojnë llogaritë e saj dhe të dhënat që kanë lidhje me kryerjen e kësaj Marrëveshjeje, të Kontratës së Konsulencës dhe të Shërbimeve dhe që këto llogari të auditohen nga auditues të caktuar nga Banka, nëse kjo kërkohet nga Banka.

6.05 Sigurimi

E pazbatueshme.

6.06 Ligji rregullues dhe zgjidhja e mos-marrë-veshjeve

a) Kjo Marrëveshje do të interpretohet në përputhje me ligjin anglez. Çdo detyrim kontraktual që lind nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje do të menaxhohet dhe interpretohet në përputhje me ligjin anglez.

b) Çdo mosmarrëveshje ose ankesë që lind ose lidhet me këtë Marrëveshje ose shkelja, përfundimi dhe pavlefshmëria e ndonjë detyrimi jokontraktual që lind nga ose lidhet me këtë Marrëveshje, e cila nuk mund të

zgjidhet miqësisht, do të zgjidhet me arbitrazh në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të UNCITRAL-it që janë në fuqi në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje. Do të ketë 1 (një) arbitër dhe autoriteti i caktuar për qëllimet e zbatimit të Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL-it do të jetë LCIA (Gjykata e Londrës për Arbitrazhin Ndërkombëtar). Vendi dhe selia e arbitrazhit do të jetë në Londër, Angli, dhe gjuha angleze do të përdoret gjatë procedimit të arbitrazhit. Me anë të kësaj, Palët heqin dorë nga çdo e drejtë sipas aktit të Arbitrazhit të vitit 1996, ose ndryshe, për të apeluar arbitrazhin, ose që të kërkojnë caktimin e një pike paraprake të ligjit nga gjykatat angleze ose kudo tjetër. Arbitri nuk është i autorizuar të sigurojë dhe ARA bie dakord se nuk do të kërkojë nga ndonjë autoritet gjyqësor, masë të përkohshme ose paraprake kundër Bankës, pavarësisht nga ndonjë dispozitë e Rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL-it.

c) Asgjë në këtë Marrëveshje nuk interpretohet si heqje dorë, tërheqje ose modifikim i rregullave nga ana e Bankës i imuniteteve, privilegjeve dhe përjashtimeve të Bankës, në përputhje me Marrëveshjen e Krijimit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, konventave ndërkombëtare ose çdo lloj ligji tjetër të zbatueshëm. Pavarësisht nga sa më sipër, Banka ka bërë një parashtrim të qartë tek arbitrazhi, duke paraqitur sipas seksionit 6.06(b) të kësaj Marrëveshjeje e më tej, dhe pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e tjera (përfshirë, pa kufizim, paprekshmërinë e arkivave të saj), Banka pranon se ajo nuk ka imunitet nga gjykimet në gjykatë dhe proceset ligjore sipas nenit 5(2) të Instrumentit të Statutit 1991, nr. 737 (Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (Imunitetet dhe Privilegjet) urdhri 1991), ose nga ndonjë dispozitë e ngjashme sipas ligjit anglez, për sa i takon zbatimit të vendimeve të një arbitrazhi, të marra në mënyrë të rregullt kundër saj, si rezultat i parashtrimit të shprehur nga ana e saj tek arbitrazhi në përputhje me seksionin 6.06(b) të kësaj Marrëveshjeje.

6.07 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme për hyrjen e saj në fuqi sipas ligjit shqiptar dhe nëse nuk pezullohet ose të përfundohet në përputhje me nenin 5, do të mbetet në fuqi të plotë derisa të përfundohen të gjitha Shërbimet dhe pagesat sipas Kontratës së Konsulencës.

6.08 Ndryshimet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me anë të pëlqimit me shkrim midis Bankës dhe Marrësit, duke u nënshkruar rregullisht nga përfaqësuesit e autorizuar.

6.09 Marrëveshja e plotë

Kjo Marrëveshje, bashkë me të gjitha shtojcat apo ndryshimet që mund të bëhen herë pas here në përputhje me klauzolën 6.08, përmban të gjitha marrëveshjet dhe mirëkuptimin midis palëve të përfshira në të dhe pezullon të gjitha propozimet që lidhen me çështjen në fjalë. Asnjëra nga palët nuk mund të varet nga asnjë marrëveshje apo përfaqësim nga pala tjetër, e cila nuk është sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

6.10 Pasardhësit

Kjo Marrëveshje është detyruese dhe konsiderohet në përfitim të pasardhësve dhe të drejtëmarrësve të autorizuar të palëve të saj.

6.11 Përjashtimi i të drejtave të palëve të treta

Kjo Marrëveshje nuk krijon ndonjë të drejtë sipas aktit të Kontratave (të drejtat e palëve të treta) të vitit 1999, të zbatueshme për çdo person apo subjekt që nuk është palë e saj, përveç të atyre personave apo subjekteve që mund të jetë një pasardhës apo nënshkrues i autorizuar, mbi të drejtat e palës që ka të drejtë të jetë palë e kësaj Marrëveshjeje.

6.12 Klauzola e vazhdimësisë

Klauzolat 3.03, 6.01, 6.02, 6.03, 6.04 dhe 6.06 duhet të vazhdojnë edhe pas përfundimit apo skadimit të kësaj Marrëveshjeje.

6.13 Gjuha

Anglishtja do të jetë gjuha e Kontratës. Të gjitha komunikimet, dokumentacioni dhe raportet sipas kësaj Marrëveshjeje dhe Kontratës së Konsulencës duhet të përgatiten dhe paraqiten në gjuhën angleze. Në çdo rast mosmarrëveshjeje mbi gjuhën, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

6.14 Garanci të tjera

ARRSH-ja duhet ose duhet të bëjë të mundur që Konsulenti, në çdo kohë dhe herë pas here, sipas kërkesës së Bankës, të ekzekutojë dhe të ofrojë dokumente të tjera të kërkuara dhe të ndërmarrë veprime të mëtejshme, të cilat në mënyrë të arsyeshme mund të kërkojnë nga Banka, me qëllim që të evidentohen, kryhen dhe t'i japin fuqi të plotë ligjore termave, kushteve, synimit dhe kuptimit të kësaj Marrëveshjeje.

6.15 Koha është thelbësore

E pazbatueshme.

6.16 Kopjet origjinale të kësaj Marrëveshjeje

Kjo Marrëveshje mund të nënshkruhet në tri kopje origjinale, secila prej të cilave së bashku do të konsiderohen si e njëjta Marrëveshje.

6.17 Logoja e BERZH-it

ARRSH-ja dhe Marrësi informohen se logoja e Bankës është një markë e regjistruar shërbimi dhe se ARRSH-ja dhe Marrësi nuk duhet ta riprodhojnë një logo të tillë pa pëlqimin e shprehur me shkrim nga ana e Bankës.

Në dëshmi sa më sipër, Palët, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre zyrtarë të autorizuar, kanë hartuar këtë Marrëveshje në gjuhën angleze, e cila do të nënshkruhet në tri kopje në datën dhe vitin e shkruar më sipër.

PËR DHE NË EMËR TË MARRËSIT

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga ministri i Financave

Shkëlqim Cani

Ministër i Financave

Datë.....

PËR DHE NË EMËR TË BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Steve Gillard

Këshilltar i Nivelit të Lartë

Bashkëpunimi Teknik

Datë.....

SHTOJCA A

FORMULARI I DEKLARATËS PËR MIRATIMIN E SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS

C28150/EBSF-2013-12-226/Rev 01

SHTOJCË E MARRËVESHJES SË GRANTIT

FORMULARI I DEKLARATËS PËR MIRATIMIN E SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS

Të nënshkruhet nga ARRSH-ja dhe të dërgohet bashkë me faturë(at) e Shërbimeve të Konsulentit.

Faturë nr.: Data e faturës: Vlera e faturës:

Vlera e Faturës:

Marrëveshja e Grantit nr. C28150/EBSF-2013-12-226/Rev01 OL: Donald Mishaxhiu

1. Në përputhje me Kontratën e Konsulencës për rrugët e Bypass-it të Fierit dhe të Vlorës:

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Projektit ["Shërbimet"], datë _____; të nënshkruar ndërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar ["ARRSH"] dhe _____ ["Konsulenti"]; si dhe në përputhje me klauzolën 2.02(d) të Marrëveshjes së Grantit për Shërbimet, të datës XXXXX, të nënshkruar ndërmjet Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ["Banka"] dhe Marrësit, ARRSH-ja deklaron se:

i) ARRSH-ja ka marrë dhe është e kënaqur me shërbimet e Konsulentit të kontraktuara sipas Kontratës së Konsulencës dhe që janë mbuluar nga fatura(t) bashkëlidhur;

ii) ARRSH-ja ka kontrolluar faturën(at) dhe të gjitha dokumentet mbështetëse që kanë lidhje me kryerjen e

Shërbimeve sipas vlerave të përcaktuara në Kontratën e Konsulencës dhe është e kënaqur që:

a) Fatura(t) është (janë) një përfaqësim real i Shërbimeve të kryera nga Konsulenti; si dhe
b) Vlera(t) e caktuara në faturën(at) janë në përputhje me vlerën(at) e përcaktuara në Kontratën e Konsulencës;

iii) Fatura(at) dhe të gjitha dokumentet mbështetëse janë përcjellë së bashku me këtë deklaratë për miratimin tek Ekipi i Faturimit, Njësinë e Kontrollit të Faturave të Bankës për pagesat; si dhe

iv) ARRSH-ja ka paguar çdo taksë të tërthortë, duke përfshirë TVSH-në, të Konsulenti në lidhje me faturat e mëparshme dhe merr përsipër të paguajë çdo taksë të tërthortë, duke përfshirë TVSH-në, për çdo faturë bashkëlidhur brenda 30 ditëve nga data e kësaj deklaratë miratimi.

2. ARRSH-ja deklaron se nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti ARRSH-ja autorizon Bankën të kryejë disbursimin për të cilin është rënë dakord në Kontratën e Konsulencës në emër të ARRSH-së.

Në dëshmi sa më sipër, Pala, që vepron në këtë cilësi, nëpërmjet përfaqësuesit të vet të autorizuar, e ka nënshkruar këtë deklaratë sot më[data].

Për dhe në emër të

Autoritetit Rrugor Shqiptar